



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 2695/Prot.
8

Tiranë, më 21.02.2023

URDHËR
Nr. 27, datë 21.02.2023

PËR
“SHPALLJEN E FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJEN E DREJTUESVE
TË NJËSIVE BAZË (DEPARTAMENTI I KIRURGJISË DHE NË DEPARTAMENTIN E
OBSTETRIKË-GJINEKOLOGJISË) NË FAKULTETIN E MJEKËSISË, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të nenit 3, 39, 45 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 5, 28, 29, 45 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nenit 4, nenit 5, pika 5, nenit 16, 22 të Rregullores së Zgjedhjeve në UMT, miratuar nga Senati Akademik me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, i ndryshuar si dhe në shkresat e Fakultetit të Mjekësisë nr. 1931/3 prot., datë 30.09.2022 “Përcillen dorëheqjet nga detyra funksionale...” dhe shkresën nr. 1931/7 prot., datë 27.12.2022 “Përgjigje shkresës nr. 2695/7 prot., datë 22.12.2022 të Rektorit të UMT...”

URDHËROJ:

1. Shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor për drejtues të njësive bazë (Departamenti i Kirurgjisë dhe në Departamentin e Obstetrikë - Gjinekologjisë), në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në datë **23.02.2023**.
2. Votimi për drejtuesit e njësive bazë të përcaktuara në pikën 1 (një) të këtij urdhri, **do të zhvillohen më 24.03.2023**.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ), Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Mjekësisë (KZF) dhe Fakulteti i Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

REKTORI
ARBEN GJATA

